

- 3) Taksa e tabelës paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKB.
- 4) Vendosja e tabelës për **qëllim identifikimi** është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve dhe subjekteve që ushtrojnë profesionet e lira.

Per vitin 2024, kjo takse eshte percaktuar, ne zbatim te ligjit nr. 9632, date 30.10.2006, "Per sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me ligjin nr.10354 date 18.11.2010, neni 3, aneksi 7, si me poshte :

Nr.	Llojet e Tabelave	Nj/Matese	B. Kucove
1.	Takse Tabele me qellim identifikim trupezuar ose jo, brenda territorit te biznesit, jo per reklame		
a.	Deri ne 2m2	Leke/m2/vit	0
b.	Mbi 2m2 deri 10m2		
	-E thjeshte (pa ndricim)	Leke/m2/vit	7000
	-Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	11500
	-Elektronike	Leke/m2/vit	15000
c.	Mbi 10m2 deri ne 20m2		
	-E thjeshte(pa ndricim)	Leke/m2/vit	5950
	-Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	9775
	-Elektronike	Leke/m2/vit	12750
d	Mbi 20m2 deri ne 40m2		
	-Ethjeshte pa ndricim	Leke/m2/vit	3850
	-Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	6325
	-Elektronike	Leke/m2/vit	8250
e.	Mbi 40m2		
	-E thjeshte pa ndricim	Leke/m2/vit	2800
	-Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	4600
	-Elektronike	Leke/m2/vit	6000
2.	Tabela me qellim orientimi, jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit		
	-Tabele Identifikuese	Leke/m2/vit	120
3.	Tabele me qellim reklamimi e levizshme,ose jo deri ne 35 m2		
	-E thjeshte pa ndricim	Leke/m2/vit	13500
4.	Tabela ne funksion te ekspozitave te hapura, panaire,spektakle, stenda reklamuese etj		
	-Te gjitha llojet dhe permasat	Leke/m2/vit	1000

Struktura e ngarkuar per dhenie leje per te vendosur tebele reklamuese eshte **Drejtoria e Planifikimit te Territorit**,prane Bashkise Kucove, bazuar ne kerkesen e subjektit qe do te vendose tabelen reklamuese

Kjo Tarife do te vilet nga drejtoria e te Ardhurave te Bashkise Kucove, per bizneset sipas afateve te caktuar, ndersa per **kategorine III**, ne momentin e dhenies per leje te ekspozites spektakle etj

Afati i Pageses

Per subjektet e biznesit te vogel, afati i pageses do te jete **deri 30 Qershor 2024**.

Per subjektet e biznesit te madh, afati i pageses do te jete deri ne **30 Qershor 2024**.

Per Ndermarrjet dhe Institucionet, afati i pageses do te jete deri ne **30 Qershor 2024**.

Per subjekte e transportit te udhetareve apo transport malli per vete e te trete ne **momentin** e pajisjes me certifikate perkatese

Per subjektet e reja

pagesa e kesaj do te behet ne momentin e regjistrimit.

Menyra e Pageses

Takses se Tabeles i nenshtrohen te gjithe subjektet juridik vendas dhe te huaj ndermarrje dhe institucione ne juridiksion te Bashkise Kucove dhe paguhet se bashku me taksat dhe tarifat e tjera lokale.

7. TAKSA E DHENIES SE LICENCAVE PER TREGTIMIN E NAFTES BRUTO DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ

Bazuar ne ligjin nr.8450 date 24.02.1999 "Per Perpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftes, Gazit dhe Nenprodukteve te tyre", ndryshuar me ligjin 9218 dt.08.04.2004 "Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.8450 si dhe VKM nr.129 dt.18.03.1999 "Per Procedurat dhe Kushteve per Dhenien e Lejeve e te Autorizimeve per Tregtimin s Naftes, Gazit e nenprodukteve te tyre" te ndryshuar me VKM nr.170 dt.25.04.2002 dhe nr.563 dt.27.08.2004, "Per disa shtesa dhe ndryshime per procedurat dhe kushtet per dhenien e lejeve dhe te autorizimeve per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj", VKM nr.970 dt.02.12.2015 "Per percaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe n/produkteve te saj", ndryshuar me VKM nr.344 dt.19.04.2017 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.970 dt.02.12.2015", bashkia jep licence per personat juridike te cilet ushtrojne veprimtarine e tyre per tregtimin e karburanteve per automjete dhe per shitjen e lendeve djegese ne territorin e bashkise Kucove.

- Autorizimet jepen nga bashkia per nje periudhe **deri ne 5 vjet** me te drejte perseritje dhe pagesa per dhenien autorizimi per dy kategorite e mesiperme eshte si vijon:

Tarifë për dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

1- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet,dhe vajrave lubrifikante **1 000 000 Lekë/liçencë 5 vjecare**

2- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse,për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë **100 000 Lekë/liçencë 5 vjecare**

- Pagesa te kryhet ne menyre perpjestimore: 1/5 e Tarifes para marrjes se licences, dhe cdo fillim viti pasardhes nga 1/5 deri ne realizim te tarifes se plote. .

Struktura e ngarkuar per dhenien e kesaj licence dhe vjeljen e detyrimit eshte **Drejtoria e Sherbimit Publik&Transportit**.

Struktura e ngarkuar per penalitetet dhe per masat shtrenguese per detyrimin e pajisjes me licence dhe pageses me force, **eshte Policia Bashkiake**

8. RENTA MINERARE

Ne mbeshtetje dhe ne respekt te ligjit nr.9975, dt. 28.07.2008 “Per Taksat Kombetare” i ndryshuar, ne zbatim te Udhezimit te Ministrise Financave nr.26 date 04.09.2008, “Per Taksat Kombetare ne R.Sh.” i ndryshuar, paragrafi 2.5, te Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017, “Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”, neni 25, pika 1 dhe pika 2.c ,njesite e qeverisjes vendore ne te cilat ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit te tokes dhe nentokes per nxjerrjen e hidrokarbureve apo dhe mineraleve, perfitojne nga ndarja e Rentes Minerare ne **masen 5 %**.

- Agjentet Fiskale per faturimin, arketimin dhe alokimin e pjeses qe i takon njesive vendore, jane Drejtorite Rajonale Tatimore, si dhe Deget e Doganave.
- Struktura pergjegjese per ndjekjen dhe realizimin e kesaj te ardhure, nga ndarja e takses kombetare, eshte Drejtoria e te Ardhurave.
- Bazuar ne Udhezimin nr.26 date 04.09.2008 te Ministrise se Financave, “Per Taksat Kombetare” i ndryshuar, Drejtoria e te Ardhurave, cdo fund muaji, ben rakordimin me Drejtorite Rajonale Tatimore apo dhe Deget e Doganave duke firmosur formularin respektiv ligjor dhe kerkon prej strukturave pergjegjese alokimin e te ardhurave nga Renta Minerare.

9. TE ARDHURA NGA TATIMI MBI TE ARDHUART PERSONALE

Te ardhurat nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale eshte detyrim ligjor dhe financiar i Drejtorise Rajonale Tatimore, ku perfshihet bashkia jone, per te arketuar, mbledhur dhe me pas shperndare sipas dispozitave ligjore, Tatimin mbi te Ardhurat Personale.

Ne zbatim te ligjit nr.9975 date 28.07.2008 “Per Taksat Kombetare ne R.Sh.”, Ligjit nr. 68/2017 date 27.04.2017 “Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”, neni 25 pika 1 dhe pika 2.ç, njesite e qeverisjes vendore, perfitojne **2 %** te te ardhurave nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale.

- Agjenti Fiskal i arketimit, mbledhjes dhe alokimit te pjese qe na takon nga kjo takse kombetare eshte Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.
- Struktura pergjegjese per rakordimin me Agjentin Fiskal dhe ndjekjen e realizimit te detyrimeve deri ne prezantimin e tyre ne buxhetin e bashkise, eshte Drejtoria e Finances dhe Buxhetit.
- Koha dhe Afati i rakordimit me agjentin fiskal eshte sipas procedures ligjore.

TARIFAT VENDORE

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e liçencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Bashkitë kanë autonomi në përcaktimin e nivelit, mënyrës së mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Llojet e tarifave vendore

Tarifat Vendore që do aplikohen në Bashkinë Kucove janë :

1. Tarifa e Shërbimit të Pastrimit dhe largimit të mbetjeve;
2. Tarifa e Ndriçimit Publik;
3. Tarifa e Shërbimit të Gjelberimit dhe Mbrojtjes Mjedisit
4. Tarifa për Zënien e Hapësirave Publike;
5. Tarifa Mirembajtja e Infrastruktura Arsimore;
6. Tarifa e Parkimit;
7. Tarifa të Liçensimit të transportit të mallrave dhe udhëtarëve;
8. Tarifa e Lejes së Udhetimeve për Shërbimet e Rastit të Udhëtarëve brenda Vendi
9. Tarifa e Shërbimit Veterinar;
10. Tarifë për Liçencë për Tregtimin e Naftës Bruto dhe Nenprodukteve të saj;
11. Tarifë Shërbimi në Tregjet Publike;
12. Tarifë për leje aktiviteti non – stop;
13. Tarifa Vendore Për Mirembajtjen e Kanaleve Kullues
14. Tarifa Vendore për Vadijen;
15. Tarifa e Shërbimit Zjarrfikës;
16. Tarifat e frekuentimit të Kopshte&Cerdheve
17. Qerate e Tokës Bujqësore e Pyjore
18. Tarifa të shërbimit administrativ;
19. Tarifa për shfrytëzimin e linjave ajrore e nentokesore për operatorët telefon&internet
20. Tarifa e perkohshme për ndotje mjedisi
21. Tarifa e Mirembajtjes Varrezave

1.TARIFA PER ZENIEN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Tarifa për zënien e përdorimit të hapësirave publike, në zbatim të ligjit 9632 datë 30.10.2006, « Per Sistemin e Taksave Vendore », neni 32, është përcaktuar në masën 70 leke/m²/muaj për vitin 2023, me të drejtën e korrektimit të këtij niveli për njesitë administrative periferike. Pageses së kësaj Tarife i nënshtrohen të gjitha subjektet që administrojnë hapësirë publike për interesat e biznesit të tyre në të gjithë shtrirjen territoriale të Bashkisë Kucove.